



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 16 datë 24.02.2026

PËR
NJOHJEN ME BUXHETIN E ALOKUAR NGA FONDI SOCIAL PËR ZBATIMIN E
PROJEKTIT “PËRQAFIMI I SHPRESËS, NJË OAZ PËR ATA QË KANË
NEVOJË” VITI 2026 DHE BASHKËFINANCIMI I BASHKISË PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.87/2025“Për buxhetin e vitit 2026”, VKB Nr.113 datë 17.12.2025 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2026”; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», VKM Nr.111 datë 23.02.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, i ndryshuar me VKM Nr.613/2024; VKB Nr. 10 datë 30.01.2025 “Për njohjen me marrëveshjen Nr.72 datë 13.01.2025, midis SHSSH dhe Bashkisë Përmet”; Vendim Nr.776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.454/2 datë 22.01.2026, Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.592/1 datë 30.01.2026 “Transferim fondesh për financimin e shërbimeve të përkujdesit social në nivel bashkie”, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Njohjen me buxhetin e alokuar nga *Fondi Social për vitin 2026* (60% për vitin e dytë të ofrimit të shërbimit), për projektin “Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë” dhe buxhetin e alokuar nga *Bashkia Përmet si pjesë e bashkëfinancimit* (40% në vitin e dytë të ofrimit të shërbimit), detajuar si më poshtë:



	Shërbim gjysmë ditor për kategoritë në nevojë	600	601	602	Financim Fondi Social	Bashkëfinancim Bashkia Përmet
1	Koordinator i qendrës	606 183	92 774		698 957	
2	Ndihmës kuzhinieri (287.3 lekë/orë x 4 orë/ditë x 22 ditë)	306 348			306 348	
3	Ushqime (240 kuota ditore)			2 940 000	1 562 870	1 377 130
4	Produkte higjienike			120 000		120 000
5	Aktivitete sociale			60 000	30 000	30 000
6	Kosto Stafi	54 987				54 987
7	Operatori Blerjeve të Përqëndruara			150 000		150 000
					2 598 175	1 732 117

2. Përqindja e financimit të Bashkisë Përmet planifikohet në strukturën e veçantë buxhetore V043AAK, në kuadër të programit buxhetor 10430 "Përkujdesi social", për shërbimet e mbështetura rishtazi në kuadër të Fondit Social 2026, referuar Udhëzuesit të Ministrisë së Financave nr. 02, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" dhe Vendimit nr. 111, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", i ndryshuar me VKM nr. 613/2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financë, Drejtoria e Projekteve, Integriteti Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave dhe Drejtoria e Shërbimit Social.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI

